

Berthama e
brendshme e
ngurte

Ordovikiani

490-443 milion vjet më parë

Në fakt kjo periudhë fillon diku rreth 510 milion vjet më parë me mbarimin e Kembrianit, dhe mbaron rreth 445 milionë vjet më parë me fillimin e Silurianit. Në këtë kohë, zona në veri të tropikëve ishte gati e tëra oqean, dhe pjesa më e madhe e botës ishte e bashkuar në një super-kontinent Gondwana, që në këtë kohë Gondwana ndodhej diku në polin e jugut dhe ishte thuajse e mbuluar nga ujërat.

Vërehet një shumëllojshmëri e botës së gjallë ku dallohen invertebratës, përfshirë graptolitet, trilobitet, brachiopodet por dheconodontet (vertebratët e hershëm). Këto kafshë, si dhe algat e kuqe dhe jeshile, peshqit primitive, cephalopode, korale, krinoide dhe gastropodë, popullonin detrat. Prania e sporeve tetrahedrale të ngjashme me ato të bimëve tokësore primitive, gjetur kohët e fundit, të çon në idenë se bimët mund të kenë filluar të shfaqen qysh në këtë kohë.

Nga ordovikiani i hershëm deri në të mesmin, toka përjetoj një klimë mesatare në të cilën moti ishte i ngrohtë dhe atmosfera përmbante mjaft lagështi. Fundi i Ordovikianit u shoqërua me një zhdukje masive të 60% të invertebrorëve dhe në total të 25% të familjeve të gjallesave për arsyen se Gondwana u pozicionua përfundimisht mbi polin e jugut gjatë ordovikianit të vonë. Kjo çoi në krijimin e akullnajave masive që u shoqërua me ulje të nivelit të deteve.

